



16/12/2024

PKK Morinë – Tentuan Të Kontrabandonin Lëndë Piroteknike, Në Shqipëri, Arrestohen 2 Shtetas

PKK Morinë

Tentuan të kontrabandonin lëndë piroteknike, në Shqipëri, arrestohen 2 shtetas.

Si rezultat i kontrolleve dhe verifikimeve që po kryhen me qëllim parandalimin dhe goditjen e krimeve kufitare, nga shërbimet e Policisë Kufitare Morinë, në bashkëpunim me shërbimet e DVP Kukë dhe shërbimin doganor, është goditur një rast i tentativës për të kontrabanduar mallra. Në hyrje të RSh-së, në vijën e dytë, gjatë kontrollit në automjetin me drejtues shtetasin Xh. L. dhe pasagjer shtetasin L. G., janë gjetur 2 kuti të mëdhaja me lëndë piroteknike, pa faturë shoqëruese, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Për këtë rast, specialistët për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Financiare të DVP Kukës arrestuan në flagrancë shtetasit L. G., 20 vjeç, banues në Durrës dhe Xh. L., 19 vjeç, banues në Vorë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për veprime të mëtejshme, për veprën penale “Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës.”

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Durrës – U kapën në flagrancë në një lokal, duke organizuar lojëra fati, me celularë, procedohen penalisht 2 shtetas

DVP Korçë, gjatë 24 orëve të fundit ▶